



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
INSPEKTORATI I MBROJTJES SË TERRITORIT

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

I mbajtur sot më datë 10 / 03/ 2023, në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, nga Njësia e Prokurimit, e përcaktuar në urdhërin e prokurimit nr. 2225 datë 01.03.2023, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, në lidhje me argumentimin dhe miratimin e dokumenteve të tenderit, specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta për kualifikim, për procedurën e prokurimit me të dhënat e mëposhtme:

OBJEKTI I PROCEDURËS : “Marrje me qera e mjeteve të transportit”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
45520000-8

VLERA E FONDIT LIMIT :

Fondi limit: **37,499,040.00** (tridhjetë e shtatë milion e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e dyzetë) lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga të ardhurat e Bashkisë Tiranë me anë të Vendimit Nr.126, datë 23.12.2022 “Për Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe detajimin e Buxhetit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë, për Vitin 2023-2025,

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), autoriteti/enti kontraktor **Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë** (Njësia e Prokurimit), ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

- **SPECIFIKIMET TEKNIKE, SASIA DHE AFATI**

1. Specifikimet teknike për makinat elektrike viti i prodhimit, 2021, 2022 0 (zero) KM (Sasia 12 cope):

Viti i prodhimit 2021,2022
Kilometrazhi 0 km

Gabina:

Numri i dyerve 4+1
Numri i vendeve 4+1

MOTORRI

Lenda djegese Elektrike 100%
Distanca ne mes te akseve min 2 600 mm – 2 700 mm
Gjatesia e pergjithshme min 4 300 mm - 4 400 mm
Lartesia min 1 600 mm - 1 700 mm
Gjeresia min 1 800 mm – 1 900 mm

Konsumi

Emetimet CO2: kombinuar 0g/km

Kategoria e efciences A+

Kapaciteti I baterise min 50-60 Kw/h

Motorri, kambio, elektronika

Fuqia maksimale min 120 kW /163 hp

Kambio automatike

Bateria Lithium-Ion

Distanca min me një karikim 300 km

Karikimi i baterise

Karikim i shpejte 0.5 H 20-80 %

Karikim i ngadalte 8 H (11KW)

Aksesore shtese:

Airbag min 4 cope

ABS+ ESC+ HAC

Kontroll Automatik i Dritave

Drita Mjegulle

Dorezat e jashtme me ngjyren e makines

Mbyllje qendrore me pult

Pasqyrat me palosje elektrike

Xhamat elektrike para dhe mbrapa
Dritat Led te dites dhe Led mbrapa
Ndezje e makines pa celes
Timon Multifunksional
Bluetooth
Pasqyrat fotokromatike
Kontroll shpejtesie (Cruis Control)
Kondicioner klimatronik
Xhamat e erret mbrapa me solar
Sensor parkimi para dhe mbrapa
Kamera 360°
Sedilje lekure dhe me ngrohje
Sistem i monitorimit te gomave
Radio me AUX+ USB
Disqe Alumini min 18

Automjetet te jene te se njetes marke
Levrimi i mjeteve brenda 10 diteve, nga nenshkrimi i kontrates

**** Në respektim të nenit 23 të LPP-së në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.***

Kontroll i plotë mbi flotën

Institucioni duhet të ruaj të drejtën të ketë kontroll të plotë mbi flotën. Kompania operationale ia mundëson teknikisht institucionit kontrollin mbi flotën e tij me anë të sistemeve GPS dhe sistemeve të menaxhimit të flotës.

Nëpërmjet sistemit GPS të inkuorporuar, institucioni ka mundësinë të ketë kontroll të plotë mbi lëvizjen dhe mënyrën e përdorimit të makinave, sipas standarteve të industrisë.

Flota e makinave qëndron në punë 365 ditë të vitit 24/7.

Automjeti është një mjet pune që është ndërtuar për të lehtësuar punën e përdoruesit. Një defekt i automjetit nuk duhet të ndalojë aktivitetin për asnjë arsye. Marja me qera operationale (leasing) e mjeteve ofron programin e zëvendësimit të menjëhershëm të mjetit me një tip tjetër, të ngjashëm ose të njëjtë deri sa defekti në automjet të jetë riparuar dhe mjeti të jetë gati për përdorim. Kontraktori duhet të marrë masa për krijimin e rezervës së mjeteve për këto raste.

Ruajtje e imazhit profesional

Marja me qera e mjeteve do të jetë për një periudhë 36 mujore, (0 deri në 36 muaj) pra do të meren me zero km dhe do të jenë në përdorim të qeramarrësit për 36 muaj me një planifikim 12 mujor 25 000 km. Kjo do të mundësojë efikasitet dhe ruajtje të imazhit të institucionit.

Mbi këtë vlerësim AK ka planifikuar marrjen me qera operationale të një sasive mjetesh rrugore.

MËNYRA E OPERIMIT:

- 1) Institucioni përcakton nevojat e tij për makina.
- 2) Kompania ofron makinat e kërkuara dhe lidh kontraten sipas afatit kohor të përcaktuar.
- 3) Makinat nuk figurojnë si aset të institucionit që i merr me qera, pronar i mjetit mbetet qeradhënësi.
- 4) Gjatë këtyre 36 muajve detyrimi i vetëm i institucionit është furnizimi i mjeteve dhe kryerja e aktivitetit të tyre.
- 5) I gjithë menaxhimi i flotës së institucionit kryhet nga kompania operationale.
Ne cmimin total të shërbimit janë të përfshira:
 - Sigurimi prim-TPL
 - Sigurimi kasko 90%
 - Taksat vjetore, regjistrimi dhe kolaudimi
 - Mirëmbajtja e mjeteve sipas manualit të prodhuesit
 - - Automjetet zvendësues në rast të mosfunksionimit të mjetit të ofruar
 - Asistencë teknike 24h/7

Për aplikimin e suksesshëm të kësaj forme të përdorimit të mjeteve, **menaxhimi nga kompania duhet të përfshijë:**

A. Kërkesa të përgjithshme

- a. Menaxhimi i të gjithë dokumentacionit të makinës përfshirë, lejen e qarkullimit, regjistrimin, nxjerrjen e targave, taksat vjetore dhe periodike, kontrollit teknik vjetor etj.
- b. Menaxhimi i të gjithë procesit të sigurimeve përfshirë: sigurimin TPL, kasko, karton jeshil dhe detyrimeve që rrjedhin në rast nevojash.
- c. Menaxhimi i aksidenteve dhe situatave që vijnë si pasojë e aksidenteve përfshirë: asistencën e menjëhershme rrugore, njerëzore, tërheqjen e makinës deri në pikën më të afërt të riparimit
- d. Menaxhimi i ripërtëritjes së përvitshme të dokumentave shtetërore dhe teknike.
- e. Kryerja e riparimeve rutinë sipas skedave të prodhuesve.
- f. Kryerja e riparimeve jo-rutinë në rast nevojë.
- g. Ndërrimi i gomave çdo 40 000 km
- h. Dhënie e makinës zëvendësuese (me të njëjtat parametra ose me të mira me specifikimet teknike në DST) brenda 3 ditëve në Tiranë dhe në rrethë në të gjitha rastet e aksidenteve dhe riparimeve.
- i. Asistencë teknike e ofruar dhe shërbimi i emergjencës 24 ore
- j. Menaxhim flote me anë të inkorporimit të sistemit GPS.

B. Kërkesa të veçanta

- a. Ofrimi me qera operationale të autoveturave

- b. Mjetet që do të ofrohen të jenë prodhim i vitit 2021,2022
- c. Mjetet elektrike të jenë të pajisura me konsolle karikimi CCS (combined charging system)
- d. Mjetet elektrike të jenë të pajisura me kabull për karikim publik në AC, si dhe kabull rrjeti për karikim në kushte shtëpiake^
- e. Automjetet të përmbushin normat dhe standardet e CE.

Artikulli	Përshkrimi	Sasia	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
	Autovetura elektrike	12 copë	Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë	36 (tridhjetë e gjashtë) muaj

Afatet e lëvrimit: Afati kohor i ofrimit të mjeteve me qera, do të jetë për një periudhë kohore prej 36 (tridhjetë e gjashtë) muaj nga momenti i dorëzimit të mjeteve.

Lëvrimi: Mjetet duhet të dorëzohen brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës.

Argumentimi:

Specifikimet teknike të artikujve objekt prokurimi janë hartuar/perciell prane sektorit Te prokurimeve me ane te kerkeses per prokurim **Nr. 1530 Prot., datë 10.02.2023** nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, bazuar në nenin 4, pika 38/b, nenin 36 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 2 të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76, si dhe bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik“ dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në të cilën është e përcaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, në të cilën është e parashikuar se: “1. Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. 2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet

të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.” si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, nenit 30, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

d. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 41 pika 5 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi, autoriteti/enti kontraktor kërkon që:

a) operatori ekonomik të ketë shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Ofertuesi duhet të paraqesë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit

(Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues.)

Argumentimi:

Përsa më sipër, referuar pikës 5 të nenit 82 të Ligjit 162 date 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, operatori ekonomik fitues (i kualifikuar në vënd të parë në SPE) duhet të paraqesi dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike si dhe dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna, jo me vonë se 5 dite nga klasifikimi i bërë nga A.K.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019,2020,2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenet 43 pika 1, 2 dhe 3 ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: bazuar në pikën 2 b, te nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 3te nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve (2020, 2021) të paraqitur në autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky autoritet.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar Nenin 43 pika 4 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

2.2.3 Deklaratë nga Operatori Ekonomik për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. (Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues.)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të e specifikimeve teknike të mallrave të ofertuara me specifikimet teknike të kërkuara nga AK.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 3 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një certifikatë të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës, që vërteton cilësinë e menaxhimit të cilesisë ISO 9001: 2015 ku te jete i perfshire objekti I prokurimit.

Çertifikata të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues të njohura nga Republika e Shqipërisë.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 të VKM-914 date 29.12.2014, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marr përsipër të realizoj sipas aktmarrëveshjes.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 (pikën 1/a), nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim distributori të autorizuar ku të vërtetohet lidhja me prodhuesin, mallrat objekt prokurimi.

Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon,e-mail, website kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun teknik, në të cilin të jenë të markuara në mënyrë të qartë dhe të dallueshme pjesët/ fragmente që i përkasin të dhënave teknike të mjetit të ofruar në përputhje me specifikimet teknike. Pjesët e katalogut me të dhënat/ specifikimet teknike të kërkuara në DST sipas përcaktimeve në shtojcën 5 duhet të jenë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara.

Argumentimi:

Kriteri 2.3.4 dhe 2.3.5 te kërkuar mesiper janë vendosur në përputhje me nenin 77 pika 4 e ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe pikën 6/b të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar).

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose me kontratë qeraje ose me marreveshje/kontrate bashkepunimi (të vlefshme), servis të specializuar për mirëmbajtjen dhe riparimin e llojit të mjetit të ofruar.

- Servisi duhet të jetë detyrimisht i autorizuar dhe çertifikuar nga prodhuesi i automjeteve për mirëmbajtje dhe riparim. Për vërtetimin e këtij kushti të paraqitet autorizim/dokument i vecantë lëshuar nga prodhuesi i automjeteve.

Shënim: Kjo kërkesë lidhet me detyrimin e kontraktorit që gjatë gjithë shtrirjes të kontratës të jetë në gjendje të sigurojë suportin teknik të mjeteve dhe pjesët e ndërrimit sipas standartit teknik të përcaktuar nga prodhuesi.).

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 , pikën 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të disponoj dhe te paraqese License te leshuar nga QKB me kodin: VII.3.B.2 „Shitblerja e mjeteve rrugore me motorr dhe ose e rimorkiove te reja ose te perdorura te autorizuar nga prodhuesi (të vlefshme),

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 , pikën 1 c dhe 2, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

2.3.8 Operatori duhet te paraqes deklarate mbi permbushjen e kushteve te specifikimeve teknike dhe termave te references dhe konkretish si parashikohen ne Shtojcen 5 dhe 7 te DST.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Dokumentat e tenderit janë hartuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Data e zhvillimit të kësaj procedure do të jetë **28.03.2023 ora 09:00** në adresën: www.app.gov.al.

Procesverbali pasi u lexua, u firmos nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit të si më poshtë: